



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:109796
Datë: 26.07.2023
Numri i dokumentit: 04526371

C.nr.647/18

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil me gjyqtaren Edije Sezairi, dhe praktikanten gjyqësore N.D. në çështjen juridike kontestimore të paditësve S.I., N.V., Sh.A., N.Sh., N.H. të cilët i përfaqëson S.I. nga Prizreni rr. kundër të paditurit K.H. të cilin me autorizim e përfaqëson avokat D.Sh. dhe avokate N.M. nga Prizreni, rr.”.....” me objekt të kontestit padi për pasurim të pabazë, me vlerë të kontestit 1.000 euro, pas seancës përgatitore me datë 26.07.2023, morri këtë:

A K T V E N D I M

- I. Ndërpritet procedura në këtë çështje juridike për shkak të vdekjes së paditëses S.I. ish nga Prizreni.
- II. Procedura do të vazhdojë pasi që trashëgimtarët të ndjerit, e marrin përsipër procedurën apo kur i thërret gjykata ta bëjë këtë, me propozimin e palës kundërshtare.

A r s y e t i m

Paditësit S.I., N.V., Sh.A., N.Sh., N.H. nga Prizreni rr. Zahir Pajaziti nr.59/9, pran kësaj gjykate kanë paraqitur padi, kundër të paditurit K.H. të cilin me autorizim e përfaqëson avokat D.Sh. dhe avokate N.M. nga Prizreni, rr.”.....” me objekt të kontestit padi për pasurim të pabazë, me vlerë të kontestit 1.000 euro.

Në seancën përgatitore të datës 26.07.2023 ka prezantuar djali paditëses S.I. dhe e ka informuar gjykatën se nëna e tij ka nderuar jetë në vitin 2017 dhe gjykatës i dorëzoi certifikatën e vdekjes për S.I.

Gjykata për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike si prove ka administruar certifikatën e vdekjes të lëshuar nga Zyra për Gjendje Civile në Prizren për Sehar Ibraimi me numër serik V 10591253, me numër të referencës 19/2017RV/19001 dhe numër rendor 213, me të cilën vërtetohet se S.I. e lindur në vitin 12.04.1936 ish nga Prizreni ka nderuar jetë me datën 18.01.2017 në Prishtinë.

Në bazë të nenit 277 të Ligjit për Procedurës Kontestimore (LPK) procesi gjyëson ndërpritet paragraf 1. pika a) kur pala ndërgjyqëse vdes dhe procedura do të vazhdohet kur trashëgimtarët e marrin përsipër procedurën, apo kur i thërret gjykata ta bëjnë këtë, me propozimin e pales kundërshtare, në nenin 280, paragraf 1. pika a), (LPK) të këtij ligji.
Nga përpara, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.647/18 të datës 26.07.2023

Praktikantja gjyqësore
Nimet Demiri

Gjyqtarja
Edije Sezairi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa ne afat prej 15 ditësh pas marrjes se te njëjtit, Gjykatës se Apelit në Prishtinë, nëpërmjet te kësaj gjykate.